



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/DH3-7 Prot.
Nr. Dok.202502389/7

Tiranë 09/12/2025

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për respektimin e afateve të arsyeshme në gjykimin e çështjes civile me paditëse Dh.C*

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SHKODËR

Për dijeni: **KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**
Tiranë

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit është paraqitur ankesa e shtetases Dh.C e cila parashtrohet se prej vitit 2021 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është regjistruar çështja gjyqësore civile për njohjen e pronës me parashkrim fitues dhe po zvarritet gjykimi i saj në këtë gjykatë.

I. Rrethanat e çështjes

Shtetasja Dh.C i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për fitimin e të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues. Fillimisht ky proces është pushuar nga gjykata.

Kështu, ankuesja ka paraqitur kërkesë padi të re në këtë gjykatë me objekt “Fitimin e pronës me parashkrim fitues” në vitin 2021. Çështja ka marrë nr.sistemi *****-*****-**-2021 me këto të dhëna:

Paditëse: Dh.C

I paditur: Arqipeshkëvia Metropolitane Shkodër – Pult

Palë të interesuara: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, Bashkia Shkodër dhe Artan Peroviç

Objekti: Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me mirëbesim mbi pasurinë e paluajtshme: ZK *****, me sipërfaqe *****m². Detyrimin e ZVRPP-së Shkodër për regjistrimin e kësaj pasurie në favor të paditëses.

Por prej vitit 2021 kur e ka depozituar kërkesë padinë dhe deri në vitin 2025 kjo çështje vijon të jetë me statusin në gjykim, duke u zvarritur për 4 vjet tashmë.

Shtetasja sqaron se kjo çështje i është caktuar me short gjyqtares Arta Llazari dhe pavarësisht interesimit të saj të vazhdueshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i është kthyer përgjigje se do të shqyrtohet kur t’i vijë radha.

Ankuesja i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, duke theksuar se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Fillimisht, kjo pronë është poseduar nga babai i ankuseses dhe pas vdekjes së tij, ajo është përballur me presione nga të tretët lidhur me pronën. Ankuesja evidenton se njohja e saj si pronare “de jure” e pronës që ajo gëzon dhe posedon “de facto” prej 33 vitesh është shumë e rëndësishme, në kuadër të sigurisë juridike.

Njëkohësisht, parashtron se është kryefamiljare dhe ka dy fëmijë jetimë, si dhe ka probleme social-ekonomike të shumta.

Pas depozitimit të ankesës, institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar procedurat për shqyrtimin e saj, referuar përcaktimeve të nenit 13, paragrafi i parë, të ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”*.

Pas adresimit të problematikës nga institucioni i Avokatit të Popullit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, fillimisht me shkresën nr.792/1 prot., datë 24.09.2025 të kësaj gjykate na është referuar si më poshtë vijon:

*“Nga verifikimet që kjo zyrë ka realizuar në Sistemin e Menaxhimit të të dhënave gjyqësore në emrin e ankueses, znj.Dh.C, është çështja me nr.sistemi *****-*****-**-2021 me të dhënat si më poshtë:*

Paditëse: Dh.C

I paditur: Arqipeshkëvia Metropolitane Shkodër – Pult

Palë të interesuara: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, Bashkia Shkodër dhe Artan Peroviç

Objekti: Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me mirëbesim mbi pasurinë e paluajtshme: ZK *****, me sipërfaqe ***** m². Detyrimin e ZVRPP-së Shkodër për regjistrimin e kësaj pasurie në favor të paditëses.

Kjo çështje rezulton se ndodhet në proces pranë gjyqtarës Arta Llazari dhe nuk ka planifikim. Gjithashtu, ju vendosim në dijeni se për shkak të vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 02.04.2025 më vendimin 189, datë 02.04.2025 është pezulluar nga detyra për një afat 6 (gjashtë) muaj.

Në të tilla kushte çështja objekt ankimi dhe të tjera në ngarkim të kësaj gjyqtare do t'i nënshtrohen rishortimit.”

Sa më sipër, rezulton se nuk është caktuar datë fare për gjykimin e kësaj çështjeje nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Pas kërkesës së përsëritur për informacion të paraqitur nga ana e institucionit në gjykatë, me shkresën nr.792/3 prot., datë 23.06.2025 referohet se, kjo çështje rezulton se në bazë të Urdhrit të Brendshëm nr.145, datë 20.05.2025 të zv.Kryetares së Gjykatës, është rishortuar dhe ka kaluar për gjykim pranë gjyqtarës Ermira Dedja.

Pas komunikimit me ankuesen, jemi informuar se ende nuk është caktuar një datë për gjykimin e kësaj çështjeje dhe vijueshmërinë e procesit gjyqësor.

II. Konstatimet dhe vlerësimi i Avokatit të Popullit

Në përfundim të procesit të shqyrtimit të ankesës së znj.Dh.C, institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se:

- 1) Nga të dhënat e administruara rezulton se çështja nr.sistemi *****-*****-**-2021 ka pësuar shtyrje të njëpasnjëshme dhe nuk është gjykuar brenda një periudhe kohore të arsyeshme.
- 2) Shtyrjet nuk kanë ardhur si rezultat i sjelljes së palës paditëse (ankueses), por kryesisht për shkak të faktorëve të brendshëm administrativë dhe të ngarkesës së lartë gjyqësore.
- 3) Kjo situatë ka cenuar të drejtën e qytetarit për një proces të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ, ku përcaktohet qartë e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve shqiptarë. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është një standard kushtetues, i garantuar dhe i sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ashtu edhe në të drejtën e brendshme në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Edhe Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe se kjo e drejtë luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 6 i KEDNJ-së zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një proces i rregullt ligjor në çështje civile dhe penale është element bazë i parimit të shtetit të së drejtës. Midis garancive që lidhen direkt ose indirekt me gjykatën janë ndër të tjera: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit publikisht), mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elementë të tillë si: barazia e armëve, **afati i arsyeshëm**, arsyetimi i vendimeve etj.

Në Kodin e Procedurës Civile (KPC), ashtu si në disa legjislacione evropiane, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga GJEDNJ-ja, janë parashikuar edhe mjete të veçanta ankimi, me qëllim përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Një nga këto mjete është edhe padia e veçantë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale dhe KPC, lidhur me zgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm. Me anë të këtij ankimi pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përshpejtim të procesit. Përmes kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim (nëse e kërkon) për vonesën e shkaktuar. Vendimi në këtë rast urdhëron gjykatën kompetente ta shqyrtojë çështjen sa më parë.

Kodi i Procedurës Civile, i cili përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera, me ndryshimet e vitit 2017, i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së respektimit të afatit të arsyeshëm të gjyimit, duke e trajtuar këtë institut në një kre të veçantë. Në dispozitën e nenit 399/2, pika 1 të këtij ligji përcaktohet se:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjyimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjyimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;

b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjyimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve,”

Natyrisht, në disa raste tejzgjatja e procesit gjyqësor ka shkaqe objektive. Në një rast të tillë kjo lloj padie mund të bëhet shkak për evidentimin e arsyeve konkrete dhe ndoshta edhe për eliminimin e tyre nga organet kompetente. Pra, ky është një mjet me efekt parandalues, në rast të tejzgjatjes pa shkak të procesit.

Dispozitat e lartpërmendura të KPC-së kanë si qëllim vendosjen për herë të parë të standardeve, si dhe një kufi në raport me termat kohorë lidhur me gjykimin brenda afatit të arsyeshëm. Kështu, në çdo rast, sipas dispozitës së nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi civil në shkallë të parë nuk duhet të zgjasë më tepër se dy vjet nga fillimi i tij.

Sjellim në vëmendje se kohët e fundit GJEDNJ-ja ka konstatuar në shumë raste të çështjeve me individë të ndryshëm kundër shtetit shqiptar se është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në fjalë.

Kështu, në çështjet **Papakostandini kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 7568/08)¹ dhe **Fortuzi kundër Shqipërisë** (kërkesa nr.29237/18)² GJEDNJ shprehet që është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në fjalë.

Duke mos shpërfillur vonesën e kuptueshme që rrjedh nga reformat e thella të sistemit të drejtësisë dhe procesi i vettingut, GJEDNJ-ja ripohoi se shtetet kishin një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të siguronin përputhjen me

¹<https://www.avokaturashitetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykes-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

²<https://www.avokaturashitetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykes-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

kërkesat e nenit 6, paragrafi 1, të Konventës, duke përfshirë atë të një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

Avokati i Popullit është në dijeni të backlog-ut të krijuar në disa gjykata në vend, por nga ana tjetër, i takon shtetit të organizojë dhënien e drejtësisë në kohën e duhur, sikurse referohet edhe në vendimet e dhëna nga GJEDNJ.

E drejta e gjyqimit brenda një afati të shpejtë dhe të arsyeshëm është jo vetëm një garanci për mbrojtjen e palëve nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave, por mbi të gjitha garanton se brenda një afati të arsyeshëm pala kërkuese do të përfitojë eventualisht nga të drejtat që i janë mohuar, duke i mundësuar asaj siguri juridike në raport me pozitën procedurale. Për më tepër, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, përveçse është një standard të cilin organi gjyqësor ka detyrimin ta respektojë apriori, është mbi të gjitha një standard që vlerësohet në mënyrë të veçantë për secilin rast konkret, nisur nga specifika, kompleksiteti, tërësia e të drejtave të shkelura apo të pretenduara, etj.

Shtetasja Dh.C ka katër vjet që pret përfundimin e shqyrtimit të çështjes për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me mirëbesim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe për më tepër gjatë vitit 2025 nuk është caktuar asnjë datë për vijimin e gjyqimit të kësaj çështjeje.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut"* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"* i ndryshuar ku përcaktohet se: *"Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive"*.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme për shpejtimin e gjyqimit të çështjes civile me paditëse Dh.C, duke i garantuar shtetases të drejtat në kuadër të procesit të rregullt ligjor.
- Marrjen e masave për respektimin e afateve të përcaktuara në kodet procedurale sa i përket përfundimit të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore.
- Parandalimin e zvarritjeve të ngjashme në të ardhmen, nëpërmjet menaxhimit më efikas të ngarkesës gjyqësore dhe përdorimit të mekanizmave ligjorë ekzistues.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Besnik DEDA

D.V